



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:273156
Datë: 26.11.2024
Numri i dokumentit: 06511557

C-III.-12-1278

Paditësi:

- 1.N K**– fshati H, Prizren
- 2.T K** – fshati H, Prizren
- 3.A K**– fshati H, Prizren

Kundër

E paditura:

- 1.Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Dritan Hoxha”, Lakrishte, nr.55 , Prishtinë,
- 2. Komuna e Gjakovës** – Gjakovë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga gjyqtarja Hajrie Shala kryesuese kolegjit dhe gjyqtarëve Gazmend Sylaj e Diellza Hoxha anëtarë të kolegjit, me dt.11 nëntor 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Procedura në këtë çështje juridike NDËRPRITET për shkak të vdekjes së paditësit M K.**
- 2. Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit kërkojnë vazhdimin e procedurës.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Paditësit N T dhe A K të gjithë nga Fshati H Prizren, kanë paraqitur padi ku kanë theksuar se kontrata mbi shitblerjen e pronës së paluatshme, e vërtetuar me nr. Ovr... të dt., në Gjykatën Komunale në Prizren e lidhur në mes të ndjerit M K dhe të paditurit Kombinatin Bujqësor Industrial “Proges Export” nga Prizreni. Kjo kontratë sipas paditësve është lidhur në kundërshtim me vullnetin e palës duke përdor presionin dhe dhunën ndaj tani të ndjerit M K dhe familjarëve të tij si dhe me kanosje të ndryshme të asaj kohe. Andaj ka propozuar që të vërtetohet se kontrata objekt i këtij kontesti është lidhur pa vullnetin e palës – paraadhësit të paditësve andaj ka propozuar që e njëjta të anulohet dhe të obligohet e paditura që paditësve si trashëgimtarë ligjor pas vdekjes së paraadhësit të tyre M K nga fshati H Prizren, të dorëzoj në posedim dhe shfrytëzim të lirë ngastra kadastrale nr.. e cila ndohet në vendin e quajtur “L” me kulturë arë kl. 2 në sipërfaqe prej 28.51, sipas fletë posedimit nr.. ZK Prizren, dhe të lejoj që paditësit N K, T K dhe A K të gjithë nga fshati H Prizren të regjistrohen si bashkëpronarë me pjesët ideale nga 1/3 në paluatshmërinë të lartë cekur.

Se bashku me padi ata kanë bashkëngjitur: kopjen e kontratës mbi shitblerjen me nr. .. e dt. .nëntor., kopjen e ekstraktit nga fletaposeduese e dt. ., kopjen e certifikatës së vdekjes të ndjerit M K, kopjen e certifikatës së lindjes të T K, kopjen e certifikatës së martesës në mes M K dhe N K kopjen e certifikatës së lindjes së N K kopjen e certifikatës së lindjes së A K Aktvendimin me të cilin shpallet inkompetente Gjykata Komunale e Prizrenit.

Me dt. 03 shtator 2018, e paditura AKP ka parashtruar Mbrojtjen e saj me të cilën ka theksuar se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit të paraqitura në padinë e tij duke i konsideruar si të pa bazuara.

Sipas AKP-se paditësit e kanë parashtruar padinë në kundërshtim me parimin procedural – legjitimacion ad causam i cili ka të bëjë me legjitimitetin real qofte atë pasiv qofte atë aktiv.

Me dt. 10 tetor 2024, gjykata ka lëshuar një urdhër me të cilin ka kërkuar që në afat prej 1 muajit nga paditësit që të parashtrojnë Aktvendimin e trashëgimisë për paraadhësin e tyre M K, por paditësit në këerkesën e parë të dt. 23 tetor 2024 kanë kërkuar afat prej 1 muaji dhe pastaj me dt. 08 nëntor 2024 e bija e të ndjerit M K, Gj K ka kërkuar afat shtese duke pas parashysh se kanë vdekur edhe paditësit tjerë, ndërsa duke pas parashysh se disa nga trashëgimtarët e rendit të dytë gjenden jashtë vendit, rezulton se ju duhet një kohë me e gjatë për ti siguruar dhe për ta shqyrtuar trashëgiminë e tyre.

Arsyetimi ligjor

Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së paditësve M K, N K T K dhe A K.

Sipas nenit 76 par.3 të Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh: “Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të

zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.”

Kurse sipas dispozitës së nenit 277 pika (a) të LPK-së: *Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim.*

Në vazhdim dispozita e nenit 280 par. 1 të LPK-së parasheh: *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.”*

Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 277 pika (a) dhe nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hajrie Shala, Kryesuese e kolegjit _____

Gazmend Sylja, anëtar _____

Diellza Hoxha, anëtare _____